



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PROGRAM ORIENTUES I MATURËS SHTETËRORE
PËR GJIMNAZIN

LËNDA:
“HISTORI”
(PROVIM ME ZGJEDHJE)

VITI SHKOLLOR 2024 – 2025
KOORDINATORE: INES TODHE

PËRMBAJTJA

1	HYRJE.....	3
2	PËRMBAJTJA E PROGRAMIT	4
3	STRUKTURA E TESTIT	4
4	LLOJET E PYETJEVE	10
5	TABELAT E REZULTATEVE TË TË NXËNIT PËR SECILËN TEMATIKË	12

1 HYRJE

Lënda e historisë është provimin me zgjedhje në përfundim të arsimin e mesëm të lartë, në kuadër të Maturës Shtetërore.

Historia në arsimin e mesëm të lartë është thelbësore në zhvillimin e qytetarëve, të cilët i kuptojnë çështjet aktuale me zgjuars, nëpërmjet kuptimit, analizës dhe përfundimeve të nxjerra nga përvojat e së shkuarës.

Studimi i lëndës së historisë i ndihmon nxënësit të zhvillojnë një ndjenjë humanizmi të gjerë, të kuptojnë zhvillimin e personalitetit të tyre, mënyrën si ata ngjasojnë dhe diferencohen nga të tjerët në raport me kohën dhe me hapësirën, të dallojnë diferencën midis supozimit dhe faktit, të mos besojnë në përgjigjen e paargumentuar dhe të respektojnë vërtetësinë e burimeve historike duke dalluar analogjinë false, të njohin abuzimet nga “mësimet” historike, të peshojnë pasojat që vijnë prej tyre, si dhe të marrin parasysh se padija për të shkuarën na bën “të burgosurit” e saj.

Detyra e programit të historisë është t’i drejtojë nxënësit për t’u bërë pjesëtarë të përgjegjshëm të shoqërisë, të cilët dinë se si të trajtojnë në mënyrë kritike një dukuri të epokës së tyre dhe të së shkuarës. **Nëpërmjet programit të historisë**, nxënësit kuptojnë se kultura e tyre dhe kulturat e tjera përbëjnë rezultatin e një procesi historik.

Programi orientues për provimin me zgjedhje të lëndës “Histori”, në kuadrin e Maturës Shtetërore për vitin shkollor 2024-2025, përbën një dokument të vlefshëm për gjimnazet, nxënësit e interesuar, mësuesit dhe specialistët e përfshirë në procesin e hartimit të testeve të Maturës Shtetërore.

Hartimi i programit orientues është mbështetur në kurrikulën me kompetenca të lëndës së historisë së arsimit të mesëm të lartë duke mbajtur parasysh formimin e njohurive dhe rezultateve të të nxënit nëpërmjet kërkimit, përdorimit të burimeve, analizës shkak-pasojë, interpretimit dhe shpjegimit e komunikimit të ngjarjes historike.

Programi orientues për përgatitjen e provimit të lëndës së historisë është mbështetur në:

- programet e lëndës së historisë bërthamë për klasat 10-11;
- programin e lëndës së historisë me zgjedhje për klasën e 12-të;
- udhëzuesin për zhvillimin e kurrikulës së gjimnazit;
- nivelet e arritjes së lëndës së historisë për klasat 10-12.

2 PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi orientues për lëndën histori për gjimnazin përfshin njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të programeve mësimore të lëndës së historisë për klasat 10-12.

- Programi orienton nxënësit për njohuritë dhe shprehjet themelore që duhet të zotërojnë për të përballuar me sukses provimin e lëndës së historisë, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Programi përmban informacionin e nevojshëm orientues për mësuesit e kësaj lënde që do të përgatisin maturantët për provimin e lëndës me zgjedhje histori.
- Programi përbën një dokument zyrtar, që duhet zbatuar me korrektesë nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të historisë, si lëndë me zgjedhje për Maturën Shtetërore.

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes dhe rigorozitet nga secili prej grupeve të interesuara. Kujdes i veçantë të tregohet nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të kësaj lënde, të cilët nuk duhet të përfshijnë për vlerësim çështje mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

3 STRUKTURA E TESTIT

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimet e Maturës Shtetërore, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë testime të nxënësve të tij, me teste që mund t'i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e testeve të Maturës Shtetërore.

Testi për lëndën histori do të ndërtohet në mënyrë të tillë që në të të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë. Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel.

Në përgatitjen për përmbushjen e rezultateve të të nxënësve të këtij programi do të përdoren tekstet mësimore të miratuara nga MASR-ja të kësaj lënde. Mund të përdoren edhe burime ndihmëse apo materiale shtesë, që sigurojnë përmbushjen e rezultateve të të nxënësve të programit orientues.

Nëpërmjet testit të lëndës së historisë në Provimin e Maturës Shtetërore, nxënësi do të vlerësohet për realizimin e koncepteve kyçe dhe kompetencave të lëndës sipas peshave të mëposhtme:

Kompetencat historike	Përshkrimi i kompetencave	Pesha
Kërkimi historik	<p>Nxënësi kupton strukturimin e kërkesave në lloje të ndryshme pyetjesh dhe çështjesh historike. Nxënësit hartojnë dhe të përmirësojnë pyetjet e tyre për të strukturuar një shqyrtim për zhvillimin e hipotezave, për përzgjedhjen dhe dhënien e fakteve për të nxjerrë dhe për të justifikuar konkluzionet e tyre.</p> <p>Treguesit kryesorë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • identifikon dhe shqyrton, individualisht dhe si pjesë e një grupi, pyetje specifike historike për periudhat antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore ose çështje që u përkasin këtyre periudhave, duke bërë testimin e hipotezave; • reflekton në mënyrë kritike për pyetje ose çështje historike që u përkasin periudhave antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore. 	20%
Përdorimi i burimeve	<p>Nxënësi bazohet në fakte historike, në prova, të cilat rrjedhin nga burime të sakta historike dhe jo nga supozime paraprake në lidhje me vlefshmërinë dhe me besueshmërinë e burimeve historike të përdorura.</p> <p>Treguesit kryesorë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon tipat e burimeve historike si një domosdoshmëri në punën e historianit dhe në dhënien e përgjigjeve të argumentuara për ndërtimin e ngjarjes historike; • vlerëson historinë gojore, me anë të së cilës dëshmitë gojore për ngjarjet e fundit historike mund ta bëjnë historinë më të gjallë në sytë e nxënësve, si dhe mund t'u lënë vend pikëpamjeve e perspektivave të atyre që nuk kanë marrë pjesë në “historinë e shkruar”; • kërkon, duke vlerësuar burimet alternative, për ndërtimin 	10%

	<p>e ngjarjes historike për periudhat antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore;</p> <ul style="list-style-type: none"> identifikon, zgjedh dhe përdor një sërë burimesh historike, duke përfshirë burimet tekstuale, vizuale, objektet dhe mjedisin historik për të argumentuar interpretimin e tij në lidhje me ngjarje apo çështje të caktuara që u përkasin periudhave antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore; vlerëson burimet e përdorura për të arritur në përfundime të arsyetuara dhe logjike për periudhat antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore. 	
<p>Interpretimi historik</p>	<p>Nxënësi përshkruan se si historianët dhe të tjerët formojnë interpretime. Nxënësi interpreton të kaluarën në mënyra të ndryshme, duke përfshirë fotografi, shfaqje, filma, tregime, muze etj.</p> <p>Treguesit kryesorë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> kupton pse historianët dhe të tjerët i kanë interpretuar ngjarjet, njerëzit dhe situatat historike që u përkasin periudhave antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore në mënyra të ndryshme; shpjegon se si dhe pse ngjarjet historike janë interpretuar në mënyra të ndryshme nëpërmjet një sërë mediash; shqyrton një sërë interpretimesh të së kaluarës që u përkasin periudhave antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore për të vlerësuar vlefshmërinë e tyre. 	10%
<p>Shkaku dhe pasoja</p>	<p>Nxënësi bën analizën e lidhjeve shpjeguese ndërmjet shkakut dhe pasojës, duke pasur parasysh marrëdhënien ndërmjet argumenteve shkakësore, dëshmive dhe interpretimeve.</p> <p>Treguesit kryesorë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> analizon ngjarjet historike që u përkasin periudhave antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore në lidhjet e tyre shkak-pasojë; shpjegon pasojat në përfundimin e ngjarjeve, të situatave 	10%

	dhe të ndryshimeve historike që u përkasin periudhave antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore.	
Shpjegimi dhe komunikimi	<p>Nxënësit zhvillojnë dëgjimin, leximin dhe shkrimin si aftësi për të kujtuar, për të përzgjedhur, për të klasifikuar dhe për të organizuar informacionin historik, duke përdorur me saktësi terminologjinë historike për përshkrimin dhe për shpjegimin e ngjarjeve në të shkuarën.</p> <p>Nxënësit duhet të përdorin edhe teknologjitë e reja sipas nevojave të tyre.</p> <p>Treguesit kryesorë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • paraqet shpjegime për periudhat antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore që janë koherente, të strukturuar dhe të arsyetuara, duke përdorur kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik; • komunikon njohuritë historike për periudhat antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore në mënyra të ndryshme, duke përdorur kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik. 	10%
Konceptet kyçe historike	Përshkrimi i koncepteve kyçe	Pesha
Kuptimi kronologjik	<p>Nxënësi përdorur saktë datat historike për të krijuar vijimësinë e ngjarjeve në një shqyrtim historik, duke përdorur termat dhe fjalorin e saktë kronologjik, si dhe duke ditur emrat dhe karakteristikat kryesore të periudhave historike. Nxënës identifikon ndryshimet brenda dhe gjatë periudhave, duke bërë lidhjet midis tyre.</p> <p>Treguesit kryesorë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përdor saktë, datat dhe fjalorin e duhur historik për periudhat antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore; • kupton organizimin kronologjik të historisë dhe vendos njerëzit dhe ngjarjet në periudhën e saktë historike (parahistorike, antike, mesjetare, moderne, 	10%

	<p>bashkëkohore), duke kuptuar dhe duke shpjeguar marrëdhëniet historike;</p> <ul style="list-style-type: none"> • ndërton linjën e kohës, duke vendosur në të periudhat historike dhe ngjarjet e rëndësishme historike; • kryen veprime për llogaritjen e kohës; • krijon një tabelë kronologjike(për vendin dhe botën) të periudhave historike, duke e pasuruar atë në vazhdimësi me informacionin e ri. 	
Ndryshimi dhe vazhdimësia	<p>Nxënësi shpjegon ndryshimin dhe vazhdimësinë brenda dhe përgjatë periudhave historike.</p> <p>Treguesit kryesorë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon ndryshimin dhe vazhdimësinë e ngjarjeve historike brenda dhe përtej periudhave historike (parahistorike, antike, mesjetare, moderne, bashkëkohore); • analizon shkallën dhe ritmin e ndryshimit, nëse ndryshimi arriti në progres dhe nëse po, për cilat ngjarje historike që u përkasin periudhave antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore; • analizon arsyet dhe rezultatet e ngjarjeve, situatave dhe ndryshimeve historike për periudhat antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore; • kupton dhe ndërgjegjësohet për veçoritë e prirjeve historike sipas periudhave (antike, mesjetare, moderne, bashkëkohore), të cilat sollën progresin e shoqërisë në shkallë kombëtare, evropiane dhe botërore. 	10%
Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare	<p>Nxënësi kupton përvojat, idetë, besimet dhe vlerate ndryshme të njerëzve dhe të shoqërive në të shkuarën dhe se si të gjitha këto kanë formësuar botën. Nxënësi kupton shumëllojshmërinë kulturore, etnike dhe fetare të shoqërive të ndryshme.</p>	10%

	<p>Treguesit kryesorë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kupton se njerëzit dhe shoqëritë e përfshira në të njëjtën ngjarje historike që i përket periudhës antike, mesjetare, moderne ose bashkëkohore, mund të kenë përvoja dhe pikëpamje të ndryshme për të njëjtën ngjarje historike. 	
Rëndësia historike	<p>Nxënësi vlerëson pse gjykimet në lidhje me rëndësinë e ngjarjeve historike, çështjeve dhe njerëzve kanë ndryshuar me kalimin e kohës.</p> <p>Treguesit kryesorë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • vlerëson rëndësinë e ngjarjeve, të njerëzve dhe të zhvillimeve historike që u përkasin periudhave antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore, në kontekstin e tyre historik dhe në ditët e sotme. 	10%

Bazuar në këtë kurrikul përmbushja e koncepteve kyçe dhe kompetencave historike që një nxënës duhet të zotërojë përgjatë gjithë zhvillimit të lëndës dhe jo vetëm, arrihet nëpërmjet 4 tematikave kryesore: *Antikiteti; Mesjeta (shek. IV – XIV); Periudha moderne (shek. XV – fillimi i shekullit XX); Periudha bashkëkohore (1919 deri më sot)*

Këto tematika, janë bazë për të ndërtuar njohuri, shkathtësi dhe qëndrime e vlera. Për secilën tematikë është **paraqitur pesha që zë secila prej tyre kundrejt orëve totale** të lëndës së historisë në zhvillimin e njohurive dhe rezultateve të të nxënës që duhet të demonstrojë nxënësi në përmbushjen e kompetencave historike.

Tematikat dhe renditja e tyre NUK nënkuptojnë që përmbajtja e testit duhet të zhvillohet në këtë renditje.

Tematika	Antikiteti	Mesjeta (shek. IV – XIV)	Periudha moderne (shek. XV – fillimi i shekullit XX)	Periudha bashkëkohore (1919 deri më sot)
Pesha	12	13	25	50

4 LLOJET E PYETJEVE

Pyetjet e testit të historisë hartohen mbi bazën e rezultateve të të nxënimit dhe testojnë njohuritë dhe aftësitë e nxënësve në tematikat e paraqitura në programin orientues.

Pyetjet që do të përdoren në testin e historisë do të jenë objektive dhe subjektive.

Në **pyetjet objektive** do të përfshihen *pyetjet me alternativa*, që do të testojnë njohuritë dhe aftësitë e nxënësve pothuajse në të gjitha tematikat. Më poshtë po japim një shembull të një pyetjeje me alternativa.

Shembull

Tematika: Periudha moderne (shekulli XV – fillimi i shekullit XX)

Rezultati i të nxënimit: identifikon pasojat e reformës protestante në qytetërimin evropian.

Pyetja:

Ndarja e të krishterëve në katolikë dhe protestantë ishte një nga rrjedhojat e: **1 pikë**

- A) ndarjes së Perandorisë Romake;
- B) zbulimeve gjeografike;
- C) Koncilit të Trentos;
- D) Reformacionit.

Përgjigja e saktë:

Alternativa D – Reformacionit

Në **pyetjet subjektive** do të përfshihen pyetjet e strukturuar të cilat testojnë aftësitë e nxënësve. *Pyetjet e strukturuar* do të testojnë njohuritë dhe aftësitë e nxënësve pothuajse në të gjitha tematikat. Këto lloj pyetjesh janë pyetje të hapura, por që e kërkojnë përgjigjen në formë të strukturuar, pasi dhe kërkesat e pyetjes janë të strukturuar.

Shembull

Tematika: Periudha Bashkëkohore ((1919deri më sot)

Rezultati i të nxënimit: evidenton ndryshimet në organizimin shtetëror gjatë periudhës së republikës dhe monarkisë shqiptare (1925-1939);

Pyetja

Historia politike e shtetit shqiptar, në vitet e para pas shpalljes së pavarësisë, karakterizohet nga një paqëndrueshmëri e theksuar, me rrëzime të shpeshta të qeverive, revolta të armatosura dhe përpjekje për njohjen dhe konsolidimin e pavarësisë në planin ndërkombëtar.

Duke krahasuar organizimin shtetëror gjatë periudhës së republikës dhe monarkisë shqiptare, identifikoni dy ndryshime institucionale midis tyre. **2 pikë**

Ndryshimi i parë:

Ndryshimi i dytë:

Model përgjigjeje e saktë:

- Në **republikë** presidenti ishte ekzekutiv pra luante edhe rolin e kryeministrit, ai ishte edhe kryetar i shtetit, ndërsa në **monarki** kryetari i shtetit ishte mbreti dhe u vendos posti i kryeministrit si post i veçantë.
- Në **republikë** parlamenti ishte i organizuar me dy dhoma, ndërsa në **monarki** u organizua në një dhomë.
- Në **monarki** u krijua Këshilli i Shtetit si organ i lartë i pavarur, që nuk ekzistonte në periudhën e **republikës**.

Nxënësi fiton

2 pikë Nëse identifikon dy nga ndryshime institucionale.

1 pikë Nëse identifikon një nga ndryshimet institucionale.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

5 TABELAT E REZULTATEVE TË TË NXËNIT PËR SECILËN TEMATIKË

Për secilën tematikë, më poshtë paraqiten njohuritë dhe rezultatet e të nxënit që duhet të demonstrojë nxënësi për të përmbushur kompetencat historike. Megjithëse njohuritë përcaktohen për secilën tematikë ato trajtohen të integruara dhe të lidhura me njëra - tjetrën.

TEMATIKA 1: Antikiteti

Njohuritë për realizimin e kompetencave historike	Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave historike
Klasa 10	
Qytetërimi antik Grek	Qytetërimi antik Grek Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • përcaktohen kohën dhe rrethanat e lindjes së qytetërimit antik grek; • shpjegon dhe krahason organizimin politik të qytet – shteteve në Greqinë antike; • shpjegon tiparet e organizimit shoqëror në Greqinë antike;
Qytetërimi antik Romak	Qytetërimi antik Romak Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • përcaktohen kohën dhe rrethanat e lindjes së qytetërimit antik romak; • shpjegon dhe krahason format e organizimit shtetëror në Romën antike; • shpjegon tiparet e organizimit shoqëror në Romën antike.
Klasa 11	
Shteti ilir	Shteti ilir Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • përcakton format kryesore të organizimit shtetëror në

	<p>territoret ilire (konfederata fisnore dhe mbretëritë ilire);</p> <ul style="list-style-type: none"> • vlerëson kontributin e mbretërive ilire dhe drejtuesve të tyre në zhvillimin e qytetërimit ilir;
Shteti i Epirit	<p>Shteti i Epirit</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon format kryesore të organizimit politik, ekonomik dhe shoqëror të shtetit të Epirit; • vlerëson rolin e shtetit të Epirit në qytetërimin ilir;
Iliria nën Perandorinë Romake.	<p>Iliria nën Perandorinë Romake.</p> <p>Nxënësi:</p> <p>gjykon mbi ndryshimet që pësoi jeta dhe kultura ilire gjatë sundimit romak.</p>
Klasa 12	
Roma dhe veçoritë e trashëgimisë së saj në botën moderne.	<p>Roma dhe veçoritë e trashëgimisë së saj në botën moderne</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerëson rëndësinë e “Të drejtës romake”;
Procesi i formimit të etnosit ilir.	<p>Procesi i formimit të etnosit ilir</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon formimin e etnosit ilir mbështetur në gjurmët arkeologjike të periudhës prehistorike dhe historike; • shpjegon konceptet <i>etnogjenezë, etnos, ilir, Iliri, Epir, epirotë</i> etj. • shpjegon dhe analizon faktet dhe burimet mbi origjinën, qytetërimin ilir, zhvillimin e tij ekonomiko-social dhe marrëdhëniet e tij me botën mesdhetare.

TEMATIKA 2: Mesjeta (Shek. IV – XIV)






Njohuritë për realizimin e kompetencave historike	Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave historike
Klasa 10	
Qytetërimi bizantin	Qytetërimi bizantin Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon shkaqet e lindjes së qytetërimit bizantin; • analizon tiparet e organizimit shtetëror të Perandorisë Bizantine; • vlerëson rolin e kodit të Justinianit në qytetërimin Bizantin duke argumentuar vlerat e tij sot;
Monarkia Angleze	Monarkia Angleze Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon procesin e krijimit të monarkisë së parë angleze; • përshkruan përmbajtjen e Kartës së Madhe të Lirive dhe vlerëson karakterin e saj; • vlerëson rolin e parlamentit në monarkinë angleze;
Monarkia Franceze	Monarkia Franceze Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • analizon tiparet e feudalizmit në Francë; • shpjegon arsyet e forcimit të pushtetit të mbretit në Francë duke analizuar tiparet e monarkisë në Francë; • krahason tiparet e parlamentin anglez me atë të asamblesë së përgjithshme në Francë;
Perandoria Osmane.	Perandoria Osmane




	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon kushtet historike të formimit të Perandorisë Osmane; • analizon tiparet e jetës ekonomike, politike dhe shoqërore në Perandorinë Osmane.
Klasa 11	
<p>Mesjeta e hershme arbërore, vazhdimësia etno.-kulturore (shek. V-X).</p>	<p>Mesjeta e hershme arbërore, vazhdimësia etno-kulturore (shek V-X)</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shqyrton të dhënat arkeologjike dhe historike që tregojnë vazhdimësinë ilire-arbërore; • gjykon për pasojat e dyndjeve sllave në Ballkan dhe territoret shqiptare;
<p>Arbëria mes Bizantit dhe Perëndimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • zhvillimet politike (shek. XI-XIV), • ekonomia dhe shoqëria në qytetin dhe fshatin mesjetar arbëror. 	<p>Arbëria mes Bizantit dhe Perëndimit</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan tiparet kryesore të organizimit politik e shoqëror të Principatës së Arbrit; • vlerëson rolin e Principatës së Arbrit si organizim shtetëror; • përcakton karakteristikat e qytetit dhe fshatit mesjetar arbëror dhe përshkruan mënyrat e jetesës në to;
<p>Organizmi politik në Arbërinë e shek. XIV-XV.</p>	<p>Organizmi politik në Arbërinë e shek. XIV-XV.</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • analizon veçoritë ekonomike, politike dhe shoqërore të principatave shqiptare gjatë shekujve XIV-XV.
Klasa 12	




<p>Krishterimi - fe zyrtare e Perandorisë Bizantine: përhapja, organizimi dhe veçoritë e krishterimit në trevat arbërore (shek. IV-XIV).</p>	<p>Krishterimi - fe zyrtare e Perandorisë Bizantine: përhapja, organizimi dhe veçoritë e krishterimit në trevat arbërore (shek. IV-XIV)</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon shkaqet që sollën Skizmën e Madhe (viti 1054). • Përcakton pasojat e Skizmës së Madhe në hapësirën shqiptare.
<p>Shoqëria arbërore dhe emigrimet arbërore në mesjetë.</p>	<p>Shoqëria arbërore dhe emigrimet arbërore në mesjetë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon shkaqet dhe tregon drejtimet e emigrimeve shqiptare në shek. XIV. • Tregon vendosjen dhe organizimin e jetës së arbërve (arvanitas, arbëresh) në Greqi dhe në Itali. • Evidenton rimëkëmbjen e qyteteve në Arbëri (shek. XIII-XIV).

TEMATIKA 3: Periudha Moderne (Shekulli XV – Fillimi I Shekullit XX)

<p>Njohuritë për realizimin kompetencave historike</p>	<p>Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave historike</p>
<p>Klasa 10</p>	
<p>Zbulimet e mëdha gjeografike.</p>	<p>Zbulimet e mëdha gjeografike</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • analizon rrethanat që shkaktuan “Zbulimet e mëdha gjeografike”; • shpjegon pasojat e zbulimeve të mëdha gjeografike.

<p> Ndryshimet fetare në Evropë.</p>	<p>Ndryshimet fetare në Evropë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • analizon shkaqet e ndryshimeve fetare në Gjermani; • analizon pasojat e reformës protestante në qytetërimin evropian; • analizon shkaqet e ndryshimeve fetare në shtetin Papal; • analizon pasojat e reformës katolike në qytetërimin evropian.
<p> Absolutizmi në Francë.</p>	<p>Absolutizmi në Francë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • analizon tiparet e absolutizmit gjatë qeverisjes së Luigjit XIV;
<p> Rusia nën drejtimin monarkëve iluministë.</p>	<p>Rusia nën drejtimin e monarkëve iluministë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përcakton konceptin monarkë iluministë; • shpjegon tiparet e qeverisjes së Pjetrit të Madh dhe të Katerinës II;
<p> Revolucioni Anglez.</p>	<p>Revolucioni Anglez</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përkufizon konceptin revolucion politik; • përcakton dhe shpjegon fazat e revolucionit anglez, duke argumentuar evolucionin politik të tij; • analizon përmbajtjen, karakterin dhe vlerat e Aktit mbi të Drejtat e Njeriut; • shpjegon tiparet e qeverisjes pas revolucionit në Angli.
<p> Revolucioni Amerikan.</p>	<p>Revolucioni Amerikan</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon shkaqet e luftës për pavarësi të kolonive angleze të Amerikës së Veriut;

	<ul style="list-style-type: none"> • vlerëson rëndësinë e Deklaratës së Pavarësisë të kolonive angleze të Amerikës së Veriut; • analizon kushtetutën amerikane dhe argumenton rëndësinë e saj në demokracinë amerikane; • analizon shkaqet e luftës civile, duke nxjerrë përfundime për rrjedhojat e saj.
<p> Revolucioni francez</p>	<p>Revolucioni francez</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • analizon shkaqet e shpërthimit të Revolucionit në Francë; • përcakton dhe shpjegon fazat e Revolucionit Francez; • analizon idetë e reja të revolucionit francez dhe ndikimin e tyre në qytetërimin botëror; • shpjegon fushat dhe karakterin e reformave të ndërmarra nga Napoleoni, duke analizuar ndikimin e tyre në qytetërimin francez dhe atë evropian; • evidenton ndryshimet politike që pësoi Evropa pas rënies së Napoleonit dhe Kongresit të Vjenës.
<p> Revolucioni i Parë dhe i Dytë Industrial.</p>	<p>Revolucioni i Parë dhe i Dytë Industrial</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përkufizon konceptin Revolucion Industrial; • shpjegon arsyet përse Anglia u bë atdheu i Revolucionit të Parë Industrial; • evidenton arritjet e këtij revolucioni në industrinë tekstile, metalurgji dhe transport; • shpjegon ndryshimet sociale që solli kyrevolucion; • argumenton ndikimin e Revolucionit të Dytë industrial me zhvillimin e industrisë dhe urbanizimit;
<p> Bashkimi i Italisë.</p>	<p>Bashkimi i Italisë</p> <p>Nxënësi:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> • shpjegon ndikimin e iluminizmit dhe të romantizmit në lindjen e nacionalizmit; • shpjegon faktorët e krijimit të shtetit të bashkuari talian;
<p> Gjermania.</p>	<p>Gjermania</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • analizon rolin e Bismarkut në bashkimin e Gjermanisë; • shpjegon reformat sociale të Bismarkut në Gjermani, si fillës është etitë mirëqenies sociale; • shpjegon tiparet e lëvizjeve punëtore në Gjermani duke evidentuar krijimin e grupimeve politike punëtore.
Klasa 11	
<p> Gjergj Kastrioti- Skënderbeu dhe Besëlidhja e Lezhës.</p>	<p>Gjergj Kastrioti- Skënderbeu dhe Besëlidhja e Lezhës.</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përcakton momentet kryesore të jetës dhe veprimtarisë së Gjergj Kastriot Skënderbeut; • shpjegon shkaqet e thirrjes së Kuvendit të Lezhës; • analizon vendimet e Kuvendit të Lezhës duke vlerësuar rëndësinë e tyre;
<p> Qëndresa e shqiptarëve kundër osmanëve dhe diplomacia e shtetit të Skënderbeut.</p>	<p>Qëndresa e shqiptarëve kundër osmanëve dhe diplomacia e shtetit të Skënderbeut.</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • analizon tiparet e shtetit nën drejtimin e Gjergj Kastriotit- Skënderbeut; • gjykon mbi marrëdhëniet e Skënderbeut me shtetet e tjera dhe vlerëson rolin e tij si diplomat; • vlerëson rëndësinë historike të periudhës së Skënderbeut për kohën dhe të ardhmen;





<p>✚ Pashallëku i Shkodrës (1757-1831).</p> <p>✚ Pashallëku i Janinës (1787 - 1822).</p>	<p>Pashallëku i Shkodrës (1757-1831).</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • tregon në hartë shtrirjen e pashallëkut të Shkodrës dhe Janinës; • shpjegon rrugën e formimit të pashallëkut të Shkodrës dhe reformat e ndërmarra në këtë pashallëk; • gjykon mbi marrëdhëniet e këtij pashallëku me Perandorinë Osmane dhe Evropën; • tregon rrugën e formimit të pashallëkut të Janinës dhe reformat e ndërmarra në këtë pashallëk; • gjykon mbi marrëdhëniet e këtij pashallëku me Perandorinë Osmane dhe Evropën; • vlerëson rëndësinë e këtyre pashallëqeve në procesin e shtetformimit dhe ndërtimit të identitetit kombëtar të shqiptarëve;
<p>✚ Rilindja Kombëtare dhe tiparet e programit politik të Rilindësve shqiptarë.</p>	<p>Rilindja Kombëtare dhe tiparet e programit politik të Rilindësve shqiptarë.</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon kushtet historike të fillesave të Rilindjes Kombëtare Shqiptare; • shpjegon tiparet e programit politik të rilindësve shqiptarë; • analizon kushtet dhe shkaqet që çuan në lindjen e çështjes shqiptare;
<p>✚ Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe veprimtaria e saj.</p>	<p>Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe veprimtaria e saj.</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • gjykon mbi vendimet e Traktatit të Shën Stefanit dhe Kongresit të Berlinit; • shpjegon organizmin dhe platformën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit; • evidenton përpjekjet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për mbrojtjen e tërësisë tokësore shqiptare; • gjykon mbi rolin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në




	ndërkombëtarizimin e çështjes kombëtare shqiptare dhe rritjes e vetëdijes kombëtare tek shqiptarët;
<p>+ Përpyjekjet e shqiptarëve për gjuhë dhe shkollë shqipe përgjatë shek. XIX.</p>	<p>Përpyjekjet e shqiptarëve për gjuhë dhe shkollë shqipe përgjatë shek. XIX.</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • evidenton përpyjekjet e para të rilindësve për ngritjen arsimore e kulturore të shqiptarëve;
<p>+ Xhonturqit dhe shqiptarët (1908-1912).</p>	<p>Xhonturqit dhe shqiptarët (1908-1912).</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • argumenton vlerat e Kongresit të Manastirit dhe faktorët që përcaktuan fitoren e alfabetit latin; • gjykon mbi rëndësinë e Kongresit të Elbasanit (1909); • shpjegon kushtet që çuan në kryengritjet anti-osmane të viteve 1910-1912;
<p>+ Kuvendi i Vlorës dhe Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë.</p>	<p>Kuvendi i Vlorës dhe Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë.</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon kalimin nga platforma autonomiste në atë të Pavarësisë; • analizon vendimet e Kuvendit Kombëtar të Vlorës; • vlerëson rëndësinë e Shpalljes së Pavarësisë.
Klasa 12	
<p>+ Islamizimi i shqiptarëve.</p>	<p>Islamizimi i shqiptarëve</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • tregon procesin e përhapjes së fesë islame në territoret shqiptare; • analizon shkaqet e islamizimit të popullsisë shqiptare;





<p>✚ Iluminizmi dhe filozofia Europën Perëndimore, shek. XVIII.</p>	<p>Iluminizmi dhe filozofia në Europën Perëndimore, shek. XVIII</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon përmbajtjen e ideve kryesore iluministe dhe evidenton rrymat kryesore të mendimit iluminist; • identifikon figurat kryesore të iluminizmit;
<p>✚ Pansllavizmi.</p>	<p>Pansllavizmi</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon konceptin e pansllavizmit dhe analizon idetë kryesore të tij;
<p>✚ Rënia e pashallëqeve shqiptare dhe lindja e Çështjes Shqiptare.</p>	<p>Rënia e pashallëqeve shqiptare dhe lindja e Çështjes Shqiptare</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon përprjekjet e shqiptarëve për shkëputje nga Perandoria Osmane pas rënies së pashallëqeve; • evidenton qëndrimin e shtetit osman ndaj shqiptarëve dhe Çështjen Shqiptare;
<p>✚ Shqiptarët dhe Tanzimati, (1839-1879).</p>	<p>Shqiptarët dhe Tanzimati (1839-1879).</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon thelbin e reformave të Tanzimatit dhe domethënien e tyre për shqiptarët





TEMATIKA 4: Periudha bashkëkohore (1919 deri më sot)





<p>Njohuritë për realizimin e kompetencave historike</p>	<p>Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave historike</p>
<p>Klasa 10</p>	
<p>✚ Fillimet e krizave të shek. XX-të. Lufta dhe paqja (1914-1920).</p>	<p>Fillimet e krizave të shek. XX-të. Lufta dhe paqja (1914-1920)</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • analizon shkaqet që çuan në fillimin e Luftës së Parë Botërore; • analizon konceptin e planit të SHBA-së për paqen në botë (14 pikat e Willsonit); • gjykon mbi vendimet më të rëndësishme të Konferencës së Paqes së arritur në Versajë;
<p>✚ Bashkimi Sovjetik (BRSS).</p>	<p>Bashkimi Sovjetik (BRSS)</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon shkaqet dhe rrjedhojat e revolucionit të vitit 1917 në Rusi; • analizon tiparet e sistemit politik në BRSS; • analizojë politikën e Stalinit si pika kulmore e zbatimit të diktaturës së proletariatit dhe të luftës së klasave; • gjykon mbi tiparet e sistemit ekonomik në BRSS;
<p>✚ Fashizmi në Itali.</p>	<p>Fashizmi në Itali</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon kushtet historike të ardhjes në pushtet të Musolinit;




	<ul style="list-style-type: none"> • analizon tiparet e sistemit politik në Italinë fashiste; • shpjegojnë tiparet e politikës së jashtme dhe të brendshme të fashizmit në Itali; • analizon tiparet e sistemit ekonomik në Italinë fashiste;
 Gjermania	Gjermania Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon kushtet historike të ardhjes në pushtet të Hitlerit; • analizon tiparet e politikës së jashtme dhe të brendshme të nazizmit në Gjermani; • gjykon antisemitizmin e Hitlerit, që solli holokaustin, duke gjykuar për rrjedhojat e tij;
 SHBA, modeli i një shteti liberal	SHBA, modeli i një shteti liberal Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • analizon tiparet e sistemit politik në SHBA; • analizon shkaqet dhe tiparet e krizës së viteve 1929 – 1933 në SHBA; • gjykon mbi “Kursin e Ri të Rusveltit si model për të dalë nga kriza ekonomike; • analizon shkaqet, synimet dhe arritjet e lëvizjeve feministe në SHBA, duke evidentuar përpjekjet e tyre për barazi sociale dhe politike;
 Lufta e Dytë Botërore (1939-1945).	Lufta e Dytë Botërore(1939-1945) Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon shkaqet që çuan në fillimin e Luftës së Dytë Botërore dhe karakterin e saj; • shpjegon rolin e grupeve të rezistencës gjatë Luftës së Dytë Botërore.
 Bota menjëherë pas Luftës së Dytë	Bota menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore (1945 – 1946)

<p>Botërore (1945 – 1946)</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • analizon kushtet historike të krijimit, karakterin dhe qëllimet e OKB-së; • tregon procesin e arritjes së paqes dhe analizon vendimet kryesore të konferencës së Jaltës, Potsdamit dhe Parisit; • gjykon mbi ndryshimet që sollën këto vendime në botën e pasluftës;
<p> BRSSS gjatë viteve 1945 – 1990</p>	<p>BRSSS gjatë viteve 1945 – 1990</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • analizon tiparet e sistemit politik në BRSS; • analizon veçoritë e politikave të brendshme dhe të jashtme të BRSS; • analizon tiparet e sistemit ekonomik në BRSS;
<p> ShBA gjatë viteve 1945 – 2000</p>	<p>SHBA gjatë viteve 1945 – 2000</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • analizon tiparet e sistemit politik në ShBA; • analizon veçoritë e politikave të brendshme dhe të jashtme të ShBA-së; • analizon tiparet e sistemit ekonomik në ShBA; • vlerëson rolin e lëvizjeve sociale në emancipimin e shoqërisë amerikane;
<p> Franca gjatë viteve 1945 – 2000.</p>	<p>Franca gjatë viteve 1945 – 2000</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • analizon tiparet e sistemit politik, ekonomik dhe shoqëror në Francë; • evidenton qëndrimin e Francës ndaj procesit të dekolonizimit; • shpjegon procesin e përfshirjes së Francës në organizmat e përbashkëta Euroatlantike dhe evidenton rolin e saj si

	iniciatorë në Komunitetin Evropian të Çelikut dhe Qymyrit.
<p> Britania e Madhe gjatë viteve</p> <p>Gjermania gjatë viteve 1945 – 1991.</p>	<p>Britania e Madhe gjatë viteve 1945 – 2000</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • analizon tiparet e sistemit politik, ekonomik dhe shoqëror në Britaninë e Madhe; • shpjegon procesin e përfshirjes së Britanisë në organizmat e përbashkëta Euroatlantike;
<p> Gjermania gjatë viteve 1945 - 1991</p>	<p>Gjermania gjatë viteve 1945 – 1991</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon procesin e krijimit të dy Gjermanive; • shpjegon rrugët dhe veçoritë e rimëkëmbjes politike, ekonomike dhe shoqërore të Republikës Federale Gjermane; • shpjegon faktorët që çuan në integrimin e Republikës Federale Gjermane në organizmat e përbashkëta Euroatlantike; • shpjegon faktorët që çuan në bashkimin e dy Gjermanive;
<p> Jugosllavia gjatë viteve 1945 – 1990.</p>	<p>Jugosllavia gjatë viteve 1945 – 1990</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • analizon tiparet e sistemit politik në Jugosllavi; • analizon veçoritë e politikave të brendshme dhe të jashtme të Jugosllavisë; • evidenton tiparet e politikës nacionale në Jugosllavi; • analizon tiparet e sistemit ekonomik dhe shoqëror në Jugosllavi;
<p> Blloku lindor gjatë viteve 1945 - 1989</p>	<p>Blloku lindor gjatë viteve 1945 – 1989</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon rrugët e vendosjes së regjimeve komuniste në Evropën Qendrore dhe Lindore;

	<ul style="list-style-type: none"> • shpjegon dallimet dhe tiparet e përbashkëta të organizimit politik, ekonomik dhe shoqëror të shteteve socialiste të bllokut lindor; • evidenton lëvizjet politike dhe shoqërore të bllokut lindor për tu shkëputur nga varësia e BRSS;
<p> Revolucionet demokratike në shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore.</p>	<p>Revolucionet demokratike në shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon rrugën e transformimeve drejt demokracisë të shteteve ish-komuniste, duke evidentuar elementet e shoqërive demokratike post-komuniste;
<p> Shpërbërja e BRSS dhe e Jugosllavisë</p>	<p>Shpërbërja e BRSS dhe e Jugosllavisë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • analizon shkaqet dhe rrjedhimet e ndryshimeve territoriale në Evropë: shpërbërja e BRSS-së dhe e Jugosllavisë, duke evidentuar si përfundim të procesit pavarësinë e Kosovës;
<p> Bashkimi Evropian.</p>	<p>Bashkimi Evropian</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • evidenton Traktatin e Mahstritit, si vazhdues të procesit të integritimit evropian dhe krijuesin e Bashkimit Evropian; • vlerëson rolin dhe rëndësinë e Bashkimit Evropian; • analizon procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian.
Klasa 11	
<p> Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj (1912-1914).</p>	<p>Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj (1912-1914).</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përcakton shtrirjen e pushtetit të qeverisë së përkohshme së Vlorës;

	<ul style="list-style-type: none"> • përshkruan veprimtarinë e qeverisë së përkohshme të Vlorës; • evidenton vështirësitë e brendshme dhe të jashtme të qeverisë së Vlorës për të ushtruar veprimtarinë e saj;
<p> Konferenca e Ambasadorëve e Londrës (1912-1913).</p>	<p>Konferenca e Ambasadorëve e Londrës (1912-1913).</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • analizon vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër për statusin; kufijtë dhe organizimin e shtetit shteti shqiptar;
<p> Shqipëria nën qeverisjen e princ Vilhelm Vidit.</p>	<p>Shqipëria nën qeverisjen e princ Vilhelm Vidit.</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon rrethanat e ardhjes së princ Vidit në krye të shtetit shqiptar; • përshkruan organizimin e principatës shqiptarë të princ Vilhelm Vidi; • shpjegon arsyet e dështimit të qeverisjes së princ Vilhelm Vidit dhe largimin e tij;
<p> Shqipëria gjatë Luftës së Parë Botërore.</p>	<p>Shqipëria gjatë Luftës së Parë Botërore.</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • evidenton qëndrimin që mbajtën Fuqitë e Mëdha ndaj Shqipërisë gjatë Luftës së Parë Botërore; • nxjerr në pah detyrat e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe reagimet e saj duke evidentuar Republikën e Korçës dhe Kongresin e Durrësit;
<p> Çështja shqiptare në Konferencën e Paqes dhe Kongresi i Lushnjës.</p>	<p>Çështja shqiptare në Konferencën e Paqes dhe Kongresi i Lushnjës.</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan dhe gjykon qëndrimin e Fuqive të Mëdha ndaj çështjes shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris;






	<ul style="list-style-type: none"> identifikon shkaqet e thirrjes së Kongresit Kombëtar të Lushnjës; analizon vendimet e Kongresit të Lushnjës; duke evidentuar rëndësinë e tyre; përshkruan veprimtarinë e qeverisë së Sulejman Delvinës dhe përpjekjet për shtrirjen e autoritetit qeverisës në të gjithë territorin e shtetit shqiptar;
<p> Shteti shqiptar gjatë viteve 1921-1924.</p>	<p>Shteti shqiptar gjatë viteve 1921-1924.</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> shpjegon veprimtarinë e grupimeve kryesore politike gjatë viteve 1921-1924; evidenton formën e organizimit të shtetit shqiptar sipas Statutit të Zgjeruar të Lushnjës; shpjegon arsyet që shkaktuan acarimin e jetës politike në Shqipëri të cilat kulmuan me Lëvizjen e Qershorit të vitit 1924; gjykon mbi arsyet e dështimit të Lëvizjes të Qershorit të vitit 1924;
<p> Republika Shqiptare (1925-1928).</p>	<p>Republika Shqiptare (1925-1928).</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> shpjegon rrethanat në të cilat u shpall Republika Shqiptare; duke evidentuar karakteristikat dhe organizimin shtetëror të saj; shpjegon përpjekjet e presidentit Ahmet Zogu për stabilizimin e situatës ekonomike dhe politike në Shqipëri; përcakton drejtimit kryesore të politikës së jashtme të shtetit shqiptar gjatë viteve 1925-1928;
<p> Monarkia Shqiptare (1928-</p>	<p>Monarkia Shqiptare (1928-1939).</p> <p>Nxënësi:</p>


<p>1939).</p>	<ul style="list-style-type: none"> • tregon rrugën e kalimit nga republika në monarki; duke evidentuar ndryshimet në organizimin shtetëror; • shpjegon marrëdhëniet me jashtë të shtetit shqiptar gjatë viteve 1925-1939;
<p>✚ Shqipëria nën pushtimin e Italisë së Musolinit (prill 1939-shtator 1943) .</p>	<p>Shqipëria nën pushtimin e Italisë së Musolinit (prill 1939-shtator 1943).</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon procesin e vendosjes së administratës italiane të pushtimit në Shqipëri; • analizon tiparet e regjimit fashist italian në Shqipëri; • analizon qëndrimet dhe programet e grupimeve kryesore politike jo fashiste në Shqipëri;
<p>✚ Shqipëria nën pushtimin gjerman (shtator 1943-nëntor 1944).</p>	<p>Shqipëria nën pushtimin gjerman (shtator 1943-nëntor 1944).</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon mënyrën e administrimit të Shqipërisë gjatë pushtimit gjerman;
<p>✚ Vendosja e regjimit komunist në Shqipëri.</p>	<p>Vendosja e regjimit komunist në Shqipëri.</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan procesin e vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri; • evidenton masat ekonomike dhe politike që mori regjimi komunist në Shqipëri gjatë viteve 1944-1948 duke gjykuar mbi pasojat e tyre;
<p>✚ Opozita shqiptare ndaj vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri.</p>	<p>Opozita shqiptare ndaj vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri.</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon tiparet e qëndresës së forcave demokratike dhe

	<p>antikomuniste ndaj regjimit komunist në Shqipëri;</p> <ul style="list-style-type: none"> • përcakton diktaturën e proletariatit dhe luftën e klasave si tipar kryesor ideologjik të regjimit komunist;
<p>Politika ekonomike e shtetit shqiptar (1946-1985).</p>	<p>Politika ekonomike e shtetit shqiptar (1946-1985).</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon politikat ekonomike të shtetit shqiptar duke evidentuar shtetëzimin, centralizimin, planifikimin, industrializimin dhe kolektivizimin e bujqësisë si tiparet kryesore të saj; • gjykon mbi pasojat që patën politikat ekonomike në jetën e shqiptarëve;
<p>Politika e jashtme e shtetit shqiptar gjatë viteve 1945-1990.</p>	<p>Tipare të represionit komunist gjatë viteve 1945-1990.</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon pasojat që pati lufta e klasave dhe shkelja e të drejtave të njeriut gjatë regjimit komunist; • liston format dhe metodat e ushtrimit të represionit nga shteti i diktaturës së proletariatit;
<p>Tipare të represionit komunist gjatë viteve 1945-1990.</p>	<p>Politika e jashtme e shtetit shqiptar gjatë viteve 1945-1990.</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë në Konferencën e Paqes në Paris; • tregon drejtimet kryesore të politikës së jashtme të shtetit shqiptar; • përcakton veçoritë e politikës së qeverisë komuniste shqiptare, të cilat çuan në izolimin e plotë ndërkombëtar të vendit;
<p>Kriza e regjimit komunist (1985-</p>	<p>Kriza e regjimit komunist (1985-1990).</p> <p>Nxënësi:</p>

<p>1990).</p>	<ul style="list-style-type: none"> • evidenton arsyet që çuan në krizën ekonomike dhe politike të shoqërisë shqiptare në gjysmën e dytë të viteve '80; • identifikon disa nga tiparet e krizës ekonomike dhe përpjekjet e drejtuesve komunistë për të lehtësuar gjendjen;
<p>Shqiptarët në ish-Jugosllavi gjatë viteve 1945-1990</p>	<p>Shqiptarët në ish-Jugosllavi gjatë viteve 1945-1990.</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan gjendjen ekonomike; politike dhe qëndresën e shqiptarëve në Jugosllavi 1945-1968; • vlerëson Kushtetutën e vitit 1974 për Kosovën; • përshkruan rrugën e rivendosjes së autoritetit serb në Kosovë dhe pasojat e tij në pozitën e popullsisë shqiptare në Jugosllavi;
<p>Lëvizja Studentore e Dhjetorit dhe shpallja e pluralizmit politik.</p>	<p>Lëvizja Studentore e Dhjetorit dhe shpallja e pluralizmit politik.</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan manifestimet e pakënaqësisë popullore që kulmuan me Lëvizjen e Studentore të Dhjetorit 1990; • përshkruan rrugën që çoi në vendosjen e pluralizmit politik dhe ndërrimin e pushteteve në Shqipëri (1991-1992);
<p>Shqipëria gjatë tranzicionit për në demokraci (1990-2013).</p>	<p>Shqipëria gjatë tranzicionit për në demokraci (1990-2013).</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan veçoritë e sistemit të ri politik ekonomik e shoqëror;
<p>Proceset e integrimit euroatlantik i Shqipërisë (1990-2013).</p>	<p>Proceset e integrimit euroatlantik i Shqipërisë (1990-2013).</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • tregon sfidat e shtetit shqiptar në rrugën e integrimit euroatlantik; <p>Rruga e Kosovës për pavarësi dhe integrim euro-atlantik.</p>

<p>✚ Rruga e Kosovës për pavarësi dhe integrim euro-atlantik.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon faktorët që ndikuan në procesin e pavarësimit dhe të integritimit euro-atlantik të Kosovës ; • vlerëson rolin që luajtën ndërkombëtarët në këtë proces;
<p>Klasa 12</p>	
<p>✚ Aspekte të jetës shoqërore shqiptare dhe elemente të evropianizimit të saj (1920-1939).</p>	<p>Aspekte të jetës shoqërore shqiptare dhe elemente të evropianizimit të saj (1920-1939)</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • tregon elementet e qytetërimit perëndimor në hartimin e legjislacionit shqiptar (kode), në ndërtimet publike dhe në jetën e përditshme; • evidenton përpjekjet për emancipimin e gruas dhe të shoqërisë shqiptare; • gjykon mbi arritjet në fushën e arsimit dhe të kulturës shqiptare; • evidenton ndarjen e shtetit nga feja si një nga parimet bazë të shtetit modern;
<p>✚ Politikat e pushtuesve italianë dhe gjermanë kundrejt nacionalizmit shqiptar.</p>	<p>Politikat e pushtuesve italianë dhe gjermanë kundrejt nacionalizmit shqiptar</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • analizon diferencat mes pushtimit italian dhe atij gjerman në lidhje me organizimin e brendshëm të Shqipërisë;
<p>✚ Diplomacia e Kombeve të Bashkuara gjatë Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1946.</p>	<p>Diplomacia gjatë Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1946</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • evidenton rëndësinë e Kartës së Atlantikut dhe parimeve të saj në nxitjen e rezistencës antifashiste; • analizon vendimet e konferencave kryesore të Aleatëve të Mëdhenj, të zhvilluara gjatë luftës dhe shpjegon ndikimin e

	<p>tyre në Botën e Pasluftës;</p> <ul style="list-style-type: none"> • krahason skenën ndërkombëtare pas dy luftërave botërore duke vënë në dukje ndryshimet dhe të përbashkëtat mes tyre;
<p> Fillimet e Luftës së Ftohtë</p>	<p>Fillimet e Luftës së Ftohtë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan ndarjen politiko-ideologjike të Evropës në përfundim të Luftës së Dytë Botërore;
<p> Shqipëria dhe Jugosllavia (1944-1948).</p>	<p>Shqipëria dhe Jugosllavia (1944-1948)</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon rolin e emisarëve jugosllavë në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore; • analizon format dhe metodat e përdorura prej jugosllavëve për vendosjen e kontrollit të tyre në Shqipëri gjatë viteve 1944-194; • argumenton rolin e faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm në prishjen e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave;
<p> Shqipëria dhe BRSS (1948-1961).</p> <p></p>	<p>Shqipëria dhe BRSS (1948-1961)</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • evidenton rolin e BS-së në raport me Shqipërinë gjatë viteve 1945-1953; • tregon ndryshimet e ndodhura në BS pas vdekjes së Stalinit dhe shpalojes së Kursit të Ri të Hrushovit, duke evidentuar ndikimin e tyre në politikën shqiptare; • shpjegon zhvillimet në Konferencën III të PPSH-së për Tiranën dhe gjykon mbi domethënien e saj për të ardhmen e Shqipërisë; • analizon arsyet e prishjes së marrëdhënieve shqiptaro-sovjetike dhe pasojat e saj për Shqipërinë;
<p> Shqipëria dhe Kina.</p>	<p>Shqipëria dhe Kina (1961-1978)</p>

	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • analizon raportet shqiptaro-kineze dhe identifikon arsyet e forcimit të tyre, sidomos në vitet '60 të shek. XX; • vë në dukje bashkëpunimin ekonomik dhe ndihmën kineze për zhvillimin e Shqipërisë; • shpjegon reflektimin e Revolucionit të Madh Kulturor kinez në Shqipëri; • arsyeton mbi shkaqet e prishjes së marrëdhënieve shqiptaro-kineze dhe pasojat e saj mbi ekonominë dhe politikën shqiptare;
<p> Karakteristikat e tranzicionit në vendet ish-komuniste.</p>	<p>Karakteristikat e tranzicionit në vendet ish-komuniste</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • evidenton situatën e re me të cilën u përballën qytetarët e vendeve të Bllokut Lindor në fillimet e periudhës së tranzicionit; • tregon rrugët e format e ndryshme për zhvillimin ekonomik dhe për kalimin nga ekonomia e centralizuar në ekonomi të tregut të lirë; • gjykon rreth aspekteve pozitive dhe negative të tranzicionit mbi shoqëritë e vendeve ish-komuniste.